



VENDIM

Nr. 155 Datë 19.12.2011

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR
PËRJASHTIMIN NGA AKSESI I PALËVE TË TRETA TË PARAQITUR
NGA ANA E KOMPANISË TAP**

Në mbështetje nenit 40, të Ligjit nr. 9946, date 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe nenit 18, gërma “e”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin nr. 107, datë 17.10.2011 të Bordit të Komisionerëve, i propozon Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.12.2011, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin nga aksesit i palëve të treta, të paraqitur nga ana e kompanisë TAP.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë kompaninë TAP për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI